



Refik Halili ka dale hapur me akuza ne drejtimin e trajnerit te Tiranës Nevil Dede. Rezultatet negative qe skuadra bardheblu ka marre ndeshjet e fundit e kane bere sponsorin e Tiranës te akuzoje trajnerin. “Dede duhet te largohet nje ore e me pare. Ka pergjegjesi kryesore per ndertimin e nje skuadre te shkaterruar. Ka sjelle ne ekip mundesa dhe jo futbolliste kur e kishte shancin te ndertonte nje skuader te mire. Qendersondimesi i Tiranës qe ka marre Dede ngjan me nje roje rrushi. Me vjen keq per tifozet dhe drejtorin Alimehmeti qe sduhet te rrije aty pasi nuk ka lidhje me ate pune qe i kane dhene te beje”, ka deklaruar Halili.